



## Përmbledhje e Aktivitetit të Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit (Java 7)

14 – 18 shkurt 2022

### 14 shkurt 2022

**Kryeministri Rama takon Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së:** Në kuadër të vizitës në OKB me rastin e fillimit të mandatit të RSH-së në Këshillin e Sigurimit, Kryeministri Rama zhvilloi një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, Guterres. Në takim mori pjesë edhe Ministria Xhacker.

SP Guterres vlerësoi punën e deritanishme të Ekipit Shqiptar në KS i cili, sic u shpreh ai, “ka surprizuar më shumë se një me një paraqitje profesionale të lartë e aktivitet dinamik”. SP theksoi momente të vecantë të situatës në Ballkanin Përendimor, duke evidentuar mungesën e ecurisë në Bosnjë dhe në dialogun mes Serbisë dhe Kosovës. Ai përmendi brishtësinë e situatës në Malin e Zi por edhe qendrimin e Bullgarisë që po pengon pakuptueshëm fillimin e bisedimeve të anëtarësimit të Maqedonsë, cka po pengon edhe Shqipërinë. Për të gjitha këto çështje KM Rama bëri sqarime të detajuara. Ai i kërkoi SP Guterres që të vizitonte rajonin pasi si BiH ashtu edhe Kosova kanë nevojë për një shtysë të fortë për të ecur më shpejt në proceset respektive. KM bëri edhe një panoramë të marëdhënieve të Shqipërisë me të gjitha vendet e rajonit dhe parashtrori iniciativat që janë duke u ndërmarrë për të hequr barrierat e panevojshme, për të forcuar mobilitetin, tregtinë e lirë dhe kontaktet njerëzore.

KM dhe SP nbdane po ashtu vlerësimet respektive lidhur me situatën përreth Ukrainës dhe eventualitetin e një sulmi nga Rusia. SP informoi mbi telefonatat që kishte pasur po atë ditë me Ministrat e Ukrainës dhe Rosisë.

**Shqipëria kremton fillimin e mandatit në Këshillin e Sigurimit:** Me datë 14 shkurt 2022, Misioni i RSH-së pranë OKB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e KM dhe Kabinetin e MEPJ, organizoi një aktivitet të dedikuar për të kremtuar fillimin e mandatit të parë të vendit në Këshillin e Sigurimit.

Në pritjen e organizuar në prani të Kryeministrit Rama, Ministres Xhacker, Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të zgjedhurve lokalë (Kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, anëtarë të

Këshillit bashkiak), bashkë-kryetarit të “Albanian Caucus” në Kongresin Amerikan, Jim Himes, moren pjesë 230 të ftuar, nga të cilat 97 ambasadorë të vendeve anëtare të OKB-së (nga 109 të ftuar të përzgjedhur për këtë kategori), përfaqësues të lartë të sekretariatit të OKB-së dhe agjensive të sistemit të OKB-së, personalitete të jetës politike e shoqërore në Nju Jork, gazetarë, anëtarë të komunitetit shqiptaro amerikan etj.

I organizuar me kujdes të vecantë, në një nga vendet më prestigjiozë të Nju Jorkut, me një cilësi të paqortueshme për cdo detaj, në lartësinë e domethënies së momentit historik, aktiviteti ia doli të shënonte momentin dhe ka lënë gjurmë tek pjesëmarrësit, të cilët, pavarësisht përkatësisë, pajtohen në vlerësimin unanimit për qartësinë e mesazhit, seriozitetin dhe profesionalizmin me të cilin Shqipëria po ushtron këtë përgjegjësi të lartë. Aktiviteti i dedikuar vetëm konfirmoi atë që vendet anëtare në OKB dhe ata gravitojnë rreth Këshillit të Sigurimit theksojnë tashmë: Shqipëria është surpriza e këtij viti në Këshill dhe kjo jo vetëm sepse vjen aty për herë të parë.

### 15 shkurt 2022

**Somalia:** Këshilli i Sigurimit (KS) zhvilloi më 15 shkurt një takim publik si dhe konsultime për situatën në Somali, bazuar në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për periudhën 6 nëntor – 31 janar 2021. Informuan James Swan, Përfaqësuesi i Posaçëm për Somalinë dhe kreu i Misionit të Asistencës së OKB-së në Somali (UNSOM); Francisco Madeira, kreu i Misionit të Unionit Afrikan (AU) në Somali (AMISOM), si dhe Kreu i Delegacionit të BE-së në OKB, Ambasador Olof Skoog.

Sipas SRSG Swan zgjedhjet janë më shumë se një vit prapa planifikimit. Deri më tani, 28 gra janë zgjedhur në Dhomën e Ulët, ose afërsisht 22%, ndërsa synimi është 30%. Al Shabaab vijon të jetë kërcënimi kryesor për sigurinë në Somali. Përçarjet politike dhe vonesat e zgjatura elektorale i kanë lejuar grupimit të bëjnë përparime, të shtojë sulmet dhe të cënojë procesin elektoral. Ka pasur përparime për sa i takon AMISOM, përfshirë zhvillimin e konceptit të përbashkët të AU-Qeverisë së Somalisë për operacionet për një mision të rikonfiguruar. Situata humanitare është e rëndë, në kufijtë e një katastrofe për shkak të mungesës së burimeve financiare. 7.7 milionë somalezë kanë nevojë për ndihmë humanitare, 4.3 milionë njerëz janë të prekur nga thatësira dhe më shumë se 270,000 janë të sapo-zhvendosur. Plani i Reagimit Humanitar për vitin 2022 është financuar aktualisht me vetëm 2%. OKB po ndërmer veprime për të forcuar ndërlidhjen mes faktorëve humanitarë, të zhvillimit dhe të ndërtimit të paqes. Ndërkohë, Al Shabaab përpiqet të përfitojë nga situata.

Ambasadori i BE nënvizoi se situata e përgjithshme në Somali vazhdon të jetë jashtëzakonisht e brishtë dhe e paqëndrueshme, përfshirë situatën e rënduar humanitare, shkaktuar nga paqëndrueshmëria politike, sfidat e vazhdueshme të sigurisë, cenueshmëria socio-ekonomike, goditjet klimatike etj. Përveç gati 1 miliard euro për zhvillimin dhe ndihmën humanitare, BE ka dhënë më shumë se 2.3 miliardë euro për AMISOM që nga viti 2007. BE ka jetësuar gjithashtu operacionin detar ATALANTA, operacionin EUTM Somalia dhe EUCAP Somalia. BE pret që Somalia të shprehë gatishmërinë e saj për të rinovuar misionin ATALANTA (mandati mbaron në 3 mars) për të paktën 9 muaj të tjerë (deri në dhjetor 2022). Në rast të kundërt, pas mbarimit të

mandatit ATALANTA nuk do të jetë më i mundur luftimi i piraterisë për të mbrojtur dërgesat e WFP dhe anije të tjera në ujërat territoriale të Somalisë. BE-ja është e gatshme të mbështesë një mision të rikonfiguruar të AU në Somali.

Ambasadori Hoxha vuri në dukje se aktorët politikë në vend duhet të respektojnë pa vonesa të mëtejshme afatet e përfundimit të zgjedhjeve në Dhomën e Ulët dhe krijimin e një shumice të re, e cila do të përballet me sfidat e sigurisë dhe të reformave. Duhet të përfshihen grupet e papërfaqësuar, sidomos gratë dhe të respektohet kuota prej 30% e pjesëmarrjes së tyre. Shqipëria ndjek me shqetësim rritjen e aktivitetit terrorist të Al-Shabaab. Përfundimi i procesit të rikonfigurimit të AMISOM është i një rëndësie të veçantë për procesin e kalimit tek forcat somaleze të përgjegjësive të mbarëvajtjes së sigurisë në vend, ndërsa negociatat e fundit për këtë qëllim mes Qeverisë së Somalisë dhe Bashkimit Afrikan janë pozitive. Nevojitet një qasje më strategjike dhe pro aktive për trajtimin e situatës së rënduar humanitare dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut, përfshi atyre të grave dhe fëmijëve.

**Central African Republic** - Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB mbi situatën në Republikën Qendrore të Afrikës (CAR) vëren se, pavarësisht armëpushimit të njëanshëm të shpallur më 15 tetor, Marrëveshja Politike për Paqe dhe Ri-pajtim e vitit 2019 dhe udhërrëfyese i Konferencës Ndërkombëtare për Liqenet e Mëdhenj e shtatorit 2021 nuk kanë shënuar përparime. Dialogu republikan pritet të rifillojë në mars 2022 pas kthimit në komitetin përkatës të opozitës.

Raporti paraqet shqetësim mbi rritjen e vazhdueshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare humanitare nga të gjitha palët. Gjatë periudhës raportuese, kanë vijuar vrasjet e civilëve, rekrutimi i fëmijëve dhe dhuna seksuale e bazuar në gjini dhe ajo e lidhur me konfliktin kundër grave dhe fëmijëve. Referencë e veçantë bëhet për operacione të kryera nga forcat e mbrojtjes dhe personeli i sigurisë (nënkuptohet kompania private rue, Wagner), të cilat kanë rezultuar në humbjen e shumë jetëve civilëve dhe abuzime.

Si pasojë e situatës së paqëndrueshme të sigurisë, raporti vëren se numri i civilëve në nevojë dhe i të zhvendosurve ka arritur nivele që nuk janë regjistruar prej pesë vitesh. Në këtë kontekst, nënvizon edhe rreziqet e hasura nga partnerët humanitarë për shpërndarjen e ndihmave.

Në raport jepet një pasqyrë e plotë mbi kontributin dhe sfidat për misionin MINUSCA, sfida të cilat përfshijnë sulme ndaj misionit, pajisjet e improvizuara shpërthyesë, privimi i lirisë së lëvizjeve apo dhe investigimit të incidenteve, si dhe fushata negative dhe gjuha e urrejtjes.

**Jemen** - Këshilli i Sigurimit diskutoi për situatën në Jemen. Anëtarët e KS-së u informuan mbi zhvillimet më të fundit në terren nga Përfaqësuesi i Posaçëm i SP të OKB-së për Jemenin, Z. Hans Grundberg dhe nga Nën-Sekeratri i Përgjithshëm për Çështjet Humanitare dhe Koordinatori i Lehtësimit të Emergjencave Z. Martin Griffiths. Në konsultimet e mbyllura që pasuan takimin mori pjesë dhe Gjenerali Michael Beary në cilësinë e kreut të Misionit të OKB-së në Mbështetje

të Marrëveshjes së Hudaydah dhe Kryetar i Komitetit të Rivendosjes. Ambasadori Ferit Hoxha, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit 2140, informoi Këshillin mbi regjimin e sanksioneve për Jemenin. Në fjalën e tij, Grundberg e përshkroi shumë shqetësuese situatën e përshkallëzimit ushtarak në Jemen, veçanërisht sa i përket impaktit të saj mbi civilët, por dhe mbi rajonin në tërësi. Ai u bëri thirrje palëve në konflikt të respektojnë të drejtën ndërkombëtare humanitare. Ai kërkoi lirimin menjëherë dhe pa kushte të gazetarëve dhe aktivistëve politikë. Duke theksuar se zgjidhja e konfliktit në Jemen duhet të jetë vetëm politike, Grundberg njoftoi mbi hapat që do të ndërmarrë në javët në vijim për të propozuar një kuadër pune për një zgjidhje politike gjithëpërfshirëse, që përfshin aspektin politik, atë të sigurisë dhe ekonomik.

USG Griffiths u shpreh se situata humanitare në Jemen është pothuajse katastrofike dhe se ndërprerja e ndihmës humanitare për vendin është një dënim me vdekje për miliona njerëz që jetojnë me këtë ndihmë. Ai i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar për të mbështetur financiarisht krizën humanitare në Jemen, veçanërisht në kuadrin e konferencës për donacione për Jemenin që do të zhvillohet Gjenevë në datën 16 mars 2022. Në konsultimet e mbyllura, Griffith informoi se OKB-ja është në kontakt intensiv me autoritetet në Jemen për lirimin e pesë pengjeve staf i organizatës në Jemen, të cilët janë kapur nga persona të armatosur në governatin e Abyanit.

Përfaqësuesi i Përhershëm i RSH-së në OKB, Ferit Hoxha, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit 2140 për regjimin e sanksioneve për Jemenin, prezantoi para raportin periodik të aktiviteteve dhe punës së këtij Komiteti për vitin e fundit.

Anëtarët e Këshillit të Sigurimit shprehën shqetësimin për përshkallëzimin e luftimeve mes palëve, rritjen e sulmeve ndërkufitare me drone, dënuan unanimisht sulmet mbi civilët dhe objektet civile, situatën e tmerrshme humanitare me të cilët po përballen popullsia civile në terren dhe nevojën për një armëpushim kombëtar sa më të shpejtë. Anëtarët mbështetën punën e Grundberg dhe zhvillimin e konsultimeve politike që ai do të ndërmarrë në dobi të zhvillimit të Kuadrit të Punës. Gjithashtu, anëtarët e KS-së u shprehën në mbështetje të një procesi politik gjithëpërfshirës të mbështetur nga OKB-ja si mënyra më e mirë për të çuar procesin përpara. Disa nga vendet anëtare të KS përveçse dënuan sulmet e Huthëve mbi EBA dhe Arabinë Saudite, ngritën shqetësimin dhe për sulmet e Koalicionit mbi civilët.

Emiratet e Bashkuara Arabe shprehën pakënaqësinë ndaj nivelit të deritanishëm të eficiencës së punës së Grundberg dhe kërkuan indirekt nga anëtarët e KS-së, që këta të fundit të mos trajtojnë aksionet e Koalicionit me të njëjtën gjuhë që trajtojnë sulmet e Huthëve në rajon.

Në emër të Shqipërisë, Ambasadori Hoxha shprehu shqetësimin për numrin e lartë të viktimave që ky konflikt po shkakton, për situatën e përkeqësuar humanitare me të cilën po përballen popullsia civile në Jemen dhe gjendjen e grave dhe fëmijëve që mbetet thellësisht problematike, pasi ato janë shumë shpesh viktimat e dhunës seksuale dhe rekrutimit. Shqipëria bëri thirrje për lirimin e grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut, atyre paqëndrues, për zbatimin e ligjit ndërkombëtar

humanitar dhe mbrojtjen e civilëve. Sa i përket situatës së sigurisë, Përfaqësuesi i Shqipërisë dënoi intensifikimin e sulmeve me dron nga Huthët mbi Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Arabinë Saudite dhe kërkoi nga KS-ja që kjo të mos lejohet.

Në konsultimet e mbyllura, Gjenerali Michael Beary informoi anëtarët e Këshillit të Sigurimit mbi punën që po bën Misioni për shmangien e militarizimit të portit të Hodeidas. Mbretëria e Bashkuar propozoi elemente për shtyp për takimin, por nuk gjeti konsensusin e EBA-ve, duke qenë se këta të fundit nuk pajtohen me mbështetjen e punës së Grundberg dhe kërkuan gjuhë më të drejtpërdrejtë për dënimin e aktiviteteve të Huthëve në EBA dhe rajon.

### 16 shkurt 2022

**CSTO** - Më 16 shkurt 2022, në KS u zhvillua debati mbi bashkëpunimin midis OKB me organizatat rajonale, me fokus tek CSTO (Collective Security Treaty Organization). Sekretari i Përgjithshëm i OKB António Guterres dhe Sekretari i Përgjithshëm i CSTO Stanislav Zas ofruan pikëpamjet e tyre për bashkëpunimin e ndërsjellë. Rusia u përfaqësua në debat nga Zv/Ministri i Jashtëm Sergej Vershinin. Në kuadër të Nenit 37, në debat morën pjesë edhe vendet e tjera anëtare të CSTO - Armenia, Bjellorusia, Kazakistani, Kirgizistani, Taxhikistani.

SP Guterres në fjalën e tij përmendi se CSTO ka qenë një partner i rëndësishëm i OKB. Tani më shumë se kurrë një OKB më efektive varet nga bashkëpunimi më i fortë dhe më i thellë me organizatat rajonale. Bashkëpunimi i tillë, përfshirë atë me CSTO, do të jetë kritik për të luftuar kërcënimet në rritje nga terrorizmi, trafikimi i paligjshëm i drogëve dhe armëve, për të promovuar stabilitetin dhe në fund, për të shpëtuar jetë njerëzore. Guterres përmendi se OKB mirëpret angazhimet e mëtejshme të vendeve anëtare të CSTO për sistemin e gatishmërisë së forcave paqeruajtëse të OKB.

SP Zas u shpreh se CSTO është e interesuar për forcimin e rolit të OKB në botë dhe e konsideron organizatën si partnerin e vet kryesor ndërkombëtar. Kjo qasje sipas tij është e sanksionuar në deklaratën e Ministrave të Jashtëm të CSTO për të riafirmuar angazhimin e tyre ndaj parimeve të Kartës së OKB dhe forcimit të bashkëpunimit për të siguruar mbikëqyrjen e plotë të zbatimit të tyre. Zas deklaroi se CSTO po konsideron pjesëmarrjen në operacionet aktuale të OKB, ndërkohë që është e gatshme të ofrojë 3.800 trupa nëpër njësi paqeruajtëse të konsoliduara, përfshirë polici ushtarake, mjekë, inxhinierë, etj. Ai mbështeti propozimin për mbajtjen e takimeve në formatin e konsultimeve të rregullta të ekspertëve nga OKB, OSBE dhe CSTO për çështje të interesit të përbashkët. Lidhur me tensionet e ngritura së fundmi, Stanislav Zas bëri me dije se situata po rrëshket drejt aktiviteteve ushtarake në shkallë të gjerë, ku tensionet janë rritur në rajonin e Evropës Lindore. Sipas tij, kjo ka ardhur nga vendosja e njësisive dhe infrastrukturës ushtarake dhe rritja e aktiviteteve ushtarake, të kombinuara këto me problemet e pazgjidhura në lindje të Ukrainës. Gjithashtu, po i kushtojmë vëmendje parësore kufijve jugorë, ku Afganistani mbetet pika e nxehtë e përhershme në terma afatgjatë.

Zv/Ministri i jashtëm rus Vershinin përmendi Kapitullin VIII të Kartës së OKB si bazën e bashkëpunimit me organizatat rajonale, të cilat kërkohen për të plotësuar përpjekjet e OKB në fushën e përgjegjësisë dhe brenda kuadrit të mandatit të tyre. Në shumicën e rasteve, theksoi ai, ato e njohin më mirë situatën në terren dhe duhet të luajnë rol kyç për përcaktimin e mënyrave të zgjidhjes së konflikteve. Në hapësirën euraziatike, këtë rol e luan veçanërisht CSTO, vuri në dukje ai, duke përmendur si përvojë pozitive rolin paqeruajtës që kryen forcat e CSTO në Kazakistan.

Vendet e tjera, përfshirë SHBA, UK, Francë, Irlandë, vendet afrikane, Indi, Meksikë, Norvegji dhe vendi ynë theksuan rolin pozitiv që parimisht kanë organizatat rajonale në uljen e tensioneve dhe qasjen ndaj problemeve lokale. Për rajonin në fjalë, SHBA vuri theksin tek rëndësia e takimeve vjetore të formatit C5+1 (pesë vendet e Azisë Qendrore plus SHBA) në nivel ministrash të jashtëm, për të adresuar sfidat me të cilat përballen këto vende. Shembull pozitiv bashkëpunimi u përmend OSBE (nga SHBA dhe Shqipëria), Bashkimi Afrikan (Gabon, Gana, Kenia), OIC (EBA), SCO (Kina), etj.

Lidhur me rolin e CSTO në Kazakistan, vendet perëndimore (SHBA, UK, Norvegji, Irlandë, Francë), përfshirë Shqipërinë, shprehën keqardhjen për humbjet e jetëve dhe ngritën shqetësimin për respektimin e shtetit ligjor, mbrojtjen e civilëve dhe respektin ndaj të drejtave të njeriut dhe ato themelore.

Kina shprehu shqetësimin për ndërhyrjet në punët e brendshme të një vendi, në këtë rast të Kazakistanit, për gjetjen e rrugëve të zgjidhjes së krizës. Përfaqësuesi kinez u shpreh i bindur se autoritetet kazake kanë tashmë aftësinë për të zgjidhur krizën dhe për të siguruar paqen në vend. Interesante ishte përmendja nga përfaqësuesi i Rusisë i faktit se CSTO i është adresuar NATO-s me nisma bashkëpunimi, si psh ndërveprimi për Afganistanin, por që këto propozime ende kanë mbetur pa marrë përgjigje.

Ne emër të Shqipërisë, ZvPërfaqësuesja e Përhershme, Dautllari, theksoi se në zgjedhjet e tyre për pjesëmarrje në organizata rajonale apo ndërkombëtare, vendet duhet të jenë të lira të vendosin vetë e pa kushtëzime. Transparenca e veprimeve të CSTO në Kazakistan nevojitet për të krijuar një klimë besimi dhe mirëkuptimi. Shqipëria përsërit rolin që luan UNRCCA me veprimtarinë e saj në rajon sa i përket luftës ndaj terrorizmit, demarkimit të kufijve apo axhendës së WPS. Duke vepruar në mirëbesim në organizata të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare, Shqipëria ka përfituar rezultate të prekshme për ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, promovimin e shtetit ligjor, të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtat e fëmijëve, grave dhe pakicave.

### 17 shkurt 2022

**Marrëveshja e Minskut/Ukraina** - Këshilli i Sigurimit i OKB-së zhvilloi një takim mbi ecurinë e procesit të zbatimit të Marrëveshjes së Minskut. Folësit parësorë ishin USG Rosmary DiCarlo, Përfaqësuesi Special i Kryesisë së radhës së OSBE-së në Ukrainë, Mikko Kinnunen dhe Drejtuesi

i Misionit të Monitorimit të OSBE-së në Ukrainë Halit, Çevik. Folën gjithashtu përfaqësues të Gjermanisë dhe Ukrainës, si palë në Formatin e Normandisë. Duke pasur parasysh situatën tejet të tensionuar përreth Ukrainës, SHBA u përfaqësua nga Sekretari i Shtetit ,Antony Blinken, Rusia nga Zv.Ministri i Punëve të Jashtme, Sergey Vershinin, ndërsa BM nga Ministri i Shtetit për Evropën në MPJ, James Claverly.

Sekretari Blinken detajoi atë që e autjti një plan të përgatitur të Rosisë për të sulmuar Ukrainën ndërsa theksoi angazhimin e SHBA për bisedime për trajtimin e çështjeve të mprehta. Duke iu referuar një letre të adresuar po atë ditë homologut rus Lavrov, ai shprehu gatishmërinë e tij për të biseduar në formate të ndryshme, NATO, OSBE, etj. Ai vuri në dukje kërcënimin e Rosisë ndaj Ukrainës përmes shtimit të mjeteve ushtarake në kufi, si dhe kërkoi nga Rusia deklaratë publike se nuk synon asnjë ndërhyrje ushtarake. Ai parashtrroi konkrctisht skenarë të ndryshëm për ndërhyrjen ushtarake ruse, pavarësisht se nuk dihet saktësisht koha e ekzekutimit të tyre.

BM dhe Franca ishin pothuajse në të njëjtën linjë për sa i takon vendosmërisë së ruajtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës. Franca vuri në fokus bisedimet në kuadrin e Formatit të Normandisë dhe nismën e OSBE për diskutim të çështjeve të sigurisë. Gjermania u shpreh në të njëjtën linjë me Francën.

Zv.Ministri i Jashtëm i Rosisë Vershenin i quajti akuzat të pabaza, meqë trupat ushtarake janë në territorin rus. Ai u fokusua tek ecuria e Marrëveshjeve të Minskut, për mozzbatimin e të cilave fajësoi Ukrainën. Hodhi poshtë pretendimet e disa vendeve për skenarë të përgatitur. Apelin e Dumës adresuar Putinit për njohjen e të ashtuquajturave “Republika Popullore të Donieskut dhe Luhanskut”, u mundua ta nënvleftësonte si “vetëm një propozim të partive politike”.

Kina theksoi domosdoshmërinë e një udhërrëfyese të qartë për zbatimin e Marrëveshjes së Minskut, cilësoi zgjerimin e NATO-s si shkak të tensioneve në Europë, si dhe kritikoi SHBA-të (pa i permendur me emër) për destabilizim në Azinë Lindore.

E10 theksuan nevojën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përmes dialogut, mbështetën Formatin e Normandisë dhe parimin e sovranitetit dhe integritetit territorial. Irlanda dhe Norvegjia ishin më të zëshme në dënimin e pranisë së trupave ushtarake ruse në kufi me Ukrainën. India theksoi se “duhet të merren parasysh shtetësimet e të gjitha palëve lidhur çështjet e sigurisë”.

Ambasadori Hoxha theksoi mbështetjen për sovranitetin dhe moscënimin territorial të Ukrainës, si dhe kërkoi tërheqjen e menjëherëshme të trupave ruse nga kufiri. Ai mbështeti zbatimin e Marrëveshjes së Minskut, si një platformë e përshtatshme ku Rusia dhe Ukraina mund të shqyrtojnë mosmarrëveshjet e tyre. Evidentoi synimin e Rosisë për instrumentalizimin e minoritetit rus për të arritur mosfunksionalitetin e Ukrainës dhe diktimin e politikave të saj. Shprehu shqetësim mbi thirrjen e Dumës ruse adresuar Presidentit Putin për njohjen e të ashtuquajturave “Republika Popullore të Donieskut dhe Luhanskut”.

Ukraina kërkoi angazhim më të madh nga OKB dhe shmangie të pasivitetit si në vitin 2008 gjatë pushtimit të Gjeorgjisë. Ajo rihodhi sërish tezën se “Rusia nuk është suksesore e ish-Bashkimit Sovjetik, ndaj nuk duhet të jetë anëtare e KS”.

Pas përfundimit të takimit, vendet anëtare të BE-së, anëtare të KS, lexuan një Deklaratë të Përbashkët, të cilës iu bashkua edhe Shqipëria. Deklarata i bën thirrje të gjitha palëve për angazhim serioz dhe zbatim të Marrëveshjes së Minskut. Gjithashtu, i kërkon Rusisë të heqë dorë nga kërcënimet ushtarake.

### 18 shkurt 2022

**Libia** - Shqipëria iu bashkua P3, përkatësisht SHBA, Britanisë së Madhe dhe Francës në kërkesën e këtyre të fundit për të pezulluar një kërkesë të përfaqësuesve të GNU adresuar Komitetit të Sanksioneve 1970 (Libia) për heqjen nga lista e sanksioneve të anëtarëve të familjes Ghadafi dhe milicit Salah Badi, për të cilin Franca më parë kishte kërkuar delistim. Kërkesa e përfaqësuesve të Libisë në NY erdhi pasi OKB-ja nuk bllokoi qeverinë e Tobruk të drejtuar nga Fathi Bashaga të zgjedhur më 10 shkurt. Kërkesa përbën një manovër politike e Kryeministrit të GNU, Dbeibah, për të fituar elektoratin e ish-diktatorit Gadafi.

**Haiti** - Këshilli i Sigurimit diskutoi rreth situatës në Haiti bazuar në Raportin e fundit të Sekretarit të Përgjithshëm (15 Shkurt 2022). Anëtarët e Këshillit u informuan në mënyrë virtuale nga zj. Helen La Lime, Përfaqësuese e Posacme e Sekretarit të Përgjithshëm (SRSG) për Haitin dhe nga përfaqësuesi i Haitit.

SRSG La Lime përmendi edhe një herë konkluzionet e raportit të Sekretarit të Përgjithshëm duke theksuar përkeqësimin e situatës në vend nga bandat, nevojën e forcimit të autoriteve vendore dhe të reformimit thelbësor të sistemit juridik, si dhe nevojën për zgjedhje elektorale. Ajo tha se 4.9 milion persona në Haiti kanë nevojë të menjëhershme për ndihmë humanitare. Zbatimi i Kodit të ri Penal dhe Kodit të Procedurës Penale duhet të nisë sa më i shpejtë, pasi dhuna e bandave të shumta që veprojnë në Haiti nuk po parandalohet siç duhet.

Vendet anëtare theksuan nevojën e marrjes sa më shpejtë të masave të duhura për përmirësimin e situatës së paqes në Haiti. Meksika i dha rëndësi krijimit të programeve të caktuara për rivendosjen e besimit në vend, duke kërkuar që OKB të shtojë praninë në Haiti. SHBA theksoi se e rëndësishme është marrja e masave konkrete në Haiti, se dialogu politik është thelbësor dhe se zgjedhjet në vend duhet të kryhen sa më shpejt, sapo kushtet ta lejojnë. Edhe vendet e tjera anëtare mbajtën të njëjtin qëndrim dhe, përveç sa më lart, nënvizuan problemin e dhunës së shkaktuar nga bandat dhe nevojën e ndëshkimit të personave përgjegjës. Të gjithë ndanë mendim të njëjtë lidhur me nevojën e rinovimit të mandatit të BINUH.



Ambasadori Hoxha theksoi se situata në Haiti mbetet shumë problematike, e paqëndrueshme dhe kriza aktuale po sjell pasoja të shumta në vend. Krimi dhe mosndëshkimi i tij duhet të konsiderohen si elementët më problematikë në Haiti. Shqipëria i vlerësoi si të domosdoshme forcimin e autoriteteve shtetërore dhe realizimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, gjithëpërfshirëse e transparente me pjesëmarrjen e grave dhe të anëtarëve të shoqërisë civile. Ajo shprehu mbështetjen e plotë për BINUH dhe ftoi autoritetet e Haitit të bashkëpunojnë me misionin.

#